

**FTESË**  
**Konventa për Integrimin Europian**  
**Grupi i Punës II (Drejtësia, Liria, Siguria)**

**Sesioni 1, Tema: Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të rregullt dhe të parregullt): Sfidat në monitorimin dhe përmbushjen e kriterëve ndërkombëtare**  
*E premte, 28 Shkurt 2020, 11:00-13:00*  
*Tirana International Hotel, Salla "Metropol"*

**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)**, në partneritet me **Slovak Foreign Policy Association**, me mbështetjen e Ministrisë së Brendshme, kanë kënaqësinë t'ju ftojnë në Sesionin e I të Grupit të Punës II me temë *"Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të rregullt dhe të parregullt): Sfidat në monitorimin dhe përmbushjen e kriterëve ndërkombëtare"*.

Me qëllim krijimin e urës së bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile e njëkohësisht forcimin e kapaciteteve në të dy sektorët, rikthehet Konventa për Integrimin Europian 2019-2021, zbatuar nga Lëvizja Europiane në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës, pas zhvillimit të suksesshëm të saj në periudhën 2014-2016. **Konventa për Integrimin Europian** përfaqëson një iniciativë që ka si qëllim të institucionalizojë debatin publik lidhur me çështjet e Bashkimit Europian, bazuar në partneritetin mes qeverisë dhe institucioneve publike, shoqërisë civile si dhe organizatave të biznesit; të forcojë aftësitë e ekspertëve në negociatat lidhur me Integrimin Europian; si dhe të transferojë eksperiencën sllovaqe në fushën e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe dialogut të përhershëm profesional. Fillimisht, ky model unik është aplikuar dhe zhvilluar me sukses nga Slovak Foreign Policy Association gjatë vitit 2003-2007 e më pas implementuar në Serbi, B&H, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut. Në kuadër të Konventës në Shqipëri, janë ngritur Grupe Pune sipas kapitujve të negociatave me BE: **(GP I: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); GP II: Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); GP III: Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11&12); GP IV: Fondet Strukturore (Kapitulli 22).**

**Grupi i Punës II**, falë përvojës së ekspertëve, do të shqyrtojë e do të diskutojë tema në fushën e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë, duke parashikuar një proces të mëtejshëm të reformës dhe pranimit në BE. Brenda Kapitullit 24, midis temave të tjera, kryesisht janë diskutuar azili, migracioni, vizat, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsioni, terrorizmi, të cilat më tej do të reflektojnë në zgjedhjen e temave të tjera të mundshme.

Në këtë Grup Pune do të organizohen katër Sesione. Këto sesione janë planifikuar të bashkë-kryesohen nga përfaqësues të *Ministrisë së Brendshme* dhe ekspertë të brendshëm të NCEI. Çdo sesion synon të mbledhë 25-30 përfaqësues nga Institucionet Shtetërore, Organizatat Ndërkombëtare, OJQ-të dhe akademia që përqendrohen në temat që lidhen me Kapitullin 24 të Acquis të BE-së.

Në **sesionin 1** të Grupit të II të Punës është përzgjedhur për diskutim miratimi i Strategjisë së Migracionit miratuar së fundmi në Shqipëri dhe sfidat që hasen për ta zbatuar dhe monitoruar atë. Ky sesion synon të nxjerrë rekomandime dhe sugjerime në lidhje me: temën e përzgjedhur dhe çështje që lidhen me kornizën ligjore; kapacitetin institucional dhe trajtimin e çështjeve.

## PROGRAMI

### Grupi i Punës II (Drejtësia, Liria, Siguria)

**Sesioni 1, Tema: Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit (të rregullt dhe të parregullt): Sfidat në monitorimin dhe përbushjen e kriterëve ndërkombëtare**

*E premte, 28 Shkurt 2020, 11:00-13:00  
Tirana International Hotel, Salla "Metropol"*

**11:00- 11:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe Kafë**

#### **Tematikat:**

- Masat që duhen ndërmarrë për të përbushur objektivat e caktuara nga Strategjia për Migracionin;
- Cilat janë sfidat që vendi mund të përballë gjatë implementimit të strategjisë: në kornizën institucionale dhe atë operative?
- Mjetet e monitorimit të strategjive ndërsektorale: Eksperienca Sllovaqe;
- Bashkëpunimi më BE-në në administrimin e fluksit të migracionit dhe përmirësimin e kapaciteteve ligjore dhe institucionale;
- Profili i Migracionit të vendit: si të menaxhohet emigrimi i parregullt?
- Procesi i harmonizimit të legjislacionit kombëtar me Acquis të BE-së në lidhje me Ligjin për të Huajt dhe Ligjin për Azilin

**11:30: 11:50 Fjalimet Hyrëse**

**Znj. Rovená Voda**, Zëvendës Ministre e Brendshme në Shqipëri

**Z. Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

**Menaxhimi i migracionit në Shqipëri dhe eksperienca sllovaqe**

**11:50: 12:20 Znj. Petra Achbergerová**, Zyra e Migracionit, Ministria e Brendshme e Sllovakisë

**12:20-12:35 Përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit**

**12:35-12:50 Përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare në Shqipëri**

**12:50-13:10 Diskutim i hapur me pjesëmarrësit**

Konkluzione dhe rekomandime